



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË GJASHTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 04.07.2019 (e Martë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h. Seanca ka vazhduar punimet edhe me datën 09.07.2019 (e Martë). Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, kryetari, z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahimimi, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Remzi Salihu, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri, ndërsa në mbledhje mungoi Vehbi Rama. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e gjashtë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Tani kalojmë te pyetjet jashtë rendit të ditës.

z.Nijazi Isaku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kame pyetje për drejtorin e Arsimit lidhur me raportin e auditorit të jashtëm. Kemi një të gjetur në këtë drejtori, lidhur me formimin e shkollës për aftësim profesional për të rritur ku kemi një mori shkelje ligjore. Po citoj sipas, auditorit të jashtëm: “menaxhmenti i komunës, me vete iniciativë kishte marr vendim për formimin e shkollës për aftësim profesional për të rritur, pa pëlqimin me shkrim përkatësisht vendimit nga MASHT. Kjo është në kundërshtim me Ligjin për Aftësim Profesional si dhe neni dy i Udhëzimit administrativ për formimin e institucioneve arsimore. Po ashtu me planin dhe programin e zbatuar nuk është marr pëlqimi i MASHT-it, me çka është shkel Udhëzimi administrativ 2014. Gjithashtu komuna nuk ka respektuar Udhëzimin administrativ të MASHT 2014 për Agjensinë qeveritare për aftësimin profesional, saktësisht neni 13 të Arsimit për Aftësim Profesional. Pra, kjo shkollë nuk është menaxhuar, mbikëqyrë nga Agjensioni Qeveritar në Lidhjen me udhëheqësinë, por edhe me kuptimin administrativ dhe pedagogjik për zgjedhjen dhe pagesën e personelit të arsimtarëve dhe stafin ndihmës. Nuk është rregulluar me asnjë rregullore të brendshme. Drejtori i shkollës, në mënyrë të pavarur e bën përzgjedhjen e kuadrit arsimor dhe teknik dhe merr vendim për lartësinë e kompensimit për të punësuarit. Të punësuarit nuk kanë kontratë pune shtesë, ata punojnë shtesë, ata punojnë dhe paguhen në bazë të kontratës të cilën e posedojnë për punën primare në shkollat e rregulla. Lidhur me këtë rregullore, ne në kuvend e kemi kërkuar vitin e kaluar lidhur me çështjen e të hyrave nga kjo shkollë. Këtu mendoj që edhe kuvendit u qit në lajthitje, kur kihet parasysh në baze të gjeturave të auditorit, krejt procesi i themelimit të kësaj ka qenë në kundërshtim me ligjin. Prandaj urgjentisht dikush duhet të jep përgjegjësi për këto shkelje ligjore. Pyetje, çka do të bëhet me te gjitha ato nxënëse që kanë vijuar këtë shkollë profesionale, a ju njohën ato diploma pas mbarimit, meqenëse shkolla paska qenë e jashtëligjshme, apo në kundërshtim me ligjin, cili është hapi i radhës nga Drejtoria e Arsimit? Pyetje për kryetarin e komunës, apo Zyrën e Prokurimit. Meqenëse direkt

keni nxjerr një deklaratë në media, për punën që po behet në riasfaltimi në rrugës nga xhamia e qytetit deri të restauron “Lindi”, ku keni potencuar që kemi dëmtuar kopanin për asfaltim për cilësi të dobëta dhe keni potencuar që nuk do ta bëni pagesën e riasfaltimit për këtë pjesë të rrugës. Mirë shumë, por shikon kontratën, zgjerimi i rrugës Drobesh deri të rruga e Mogilles, e nënshkruar nga kompania dhe komuna në vlerë prej 304 mijë e 400 euro. Kjo kontratë është nënshkruar në vitin 2017. Afati kohor është 14 muaj, e që rrjedhimisht nuk kemi pas ndonjë pagesë nga komuna për vitin 2018. Këtë e bazoj në prezantimin e pasqyrave financiare për vitin 2018 nga komuna, por si informatë është cekur në informatën e kryetarit se ky projekt është dyvjeçar 2018-19. Me këtë kontratë janë parapa 4 segmente të rrugës, po po ndalemi te segmenti dy i rrugës, meqenëse bëhem fjalë pak me herët dhe çfarë paramase ka parapa qajo rruge. Si rrugë është parapa 1 km ose 1000 metra është me grrye 3 centimetra dhe shtrurja e asfaltit shtresë 4 centimetra në përmasat qyshe është parapa në kontratë. Po bëhet fjalë për 4 centimetra asfalt, andaj cila do të jete cilësia e riasfaltimit të kësaj rruge ku sipas paramasave në këtë rrugë është parapa trashësia vetëm 4 centimetra dhe me këtë vlerë të paguar prej 304 mijë e 400 euro për këto katër segmente të rrugëve në totalin prej 11 klm, por janë vetëm dy rrugë sipas kontratës që kanë mu shtru me asfalt dhe përmasat prej 4 centimetra në totalin e rrugëve krej 6 km. Të dashur qytetar, vlerësone vet sa ka kushtuar për këto gjashtë kilometra, por edhe me këto 6 kilometra cilësia e asfaltit është shumë e dobët. Tanimë qytetarët e kanë vërejt këtë, e kjo është keqpërdorim i parasë publike, epo thjesht është hajni. Pyetja, kur përfundon kjo kontratë me këtë kompani?

znj. Idajete Pira: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kualiteti i dobët i asfaltimeve në Komunën e Vitisë, përçdo vit po na nxjerr telashe, si dhe po kërkon shpenzime serike për shkak të cilësisë së dobët e cila vjen si pasoj e përfitimeve të njerëzve kompetent të dhënies së tenderëve, fatkeqësisht shumë e shumë rrugë në Komunën e Vitisë kanë fatin e njëjtë. Të njëjtin fat e ka edhe rruga në Pozharan, përgjatë sheshit, thuajse është shkatërruar fare dhe është bërë gati e pakalueshme, si për këmbësor ashtu edhe për automjete. Ky është një shqetësim i qytetarëve. Kanë edhe një shqetësim tjetër, meqenëse unë punoj në shëndetësi, jam dëshmitare e padrejtësive që janë duke u bërë tek punëtorët shëndetësor që janë duke punuar me KARITAS. Është fjala për pagat e tyre, këta punëtor kanë një pagë shumë më të ultë se sa punëtorët që punojnë në mënyrë të rregull, mirëpo çka është me e keqja, nuk janë të pagu që tre muaj. Në e dimë që një pjesë të përgjegjësive në këtë rast e ka edhe komuna, prandaj dashta ta ngris këtë çështje në diskutim. Kërkoj nga ju që të përkrahën këta punëtorë dhe të ndërmerreni hapa që këta punëtor sikur se të gjithë punëtorët e tjerë të sektorëve të tjerë ta gëzojnë të drejtën e pagës së rregull.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam dy pyetje, kur do të fillon asfaltimi i rrugës Skifteraj-Stubell e Poshtme dhe pyetja tjetër, pasi që gypat prej Letnices deri në Viti kanë ardhur që një kohe të gjatë, pse nuk bëhet kyqja në ata gypa që të pimë ujë në prej aty e jo prej gypave të vjetër.

z.Zekirja Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Pyes për gjendjen e ujësjellësve në përgjithësi, po në veçanti për atë të Smirës, se kur do të vazhdon faza e dytë e punimeve. Gjendja këto ditë në Smirë është shumë e rëndë sa i përket uji të pijshëm, sepse kanë filluar të shterojnë pusët dhe qytetarët kanë fillu të furnizohen me cisterna. Kështu që, kërkohet shpejtimi i punimeve rreth ujësjellësit, ku dhe si propozim i imi, do të ishte që në buxhetin e ardhshëm, shumica investimeve kapitale të ndahen për ujin e pijshëm, sepse uji është jetik. Pyetje tjetër, kam rreth aparatit apo kioskës për dhënë e dokumenteve personale në Pozharan. Këtë pyetje e kam për drejtorin e Administratës, se a është aparati funksional dhe në shërbim të qytetarëve, nëse nuk është, atëherë kur do të jetë i rregulluar që të shërbehen qytetarët, pasi që tani vinë mërgimtarët dhe shtohen kërkesat për dokumente personale.

znj. Mirlinda Sadiku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam pyetje për ushtruesin e detyrës së drejtorit të Bujqësisë. Nuk e di sa jeni në dijeni, ekziston një vendim i qeverisë, i cili ma marr për obligim që të ju bëj pagesat fshatarëve të cilët kanë pas dëme në kulturat e tyre bujqësore, pse nuk është bërë kjo deri tash ka ndodh në disa komuna të Kosovës, mirëpo në Viti me sa e di unë nuk ka ndodh. Jemi dëshmitar që rruga e Binçes është me një gjendje shumë të keqe, e dimë që Binça ka një numër të madhe të njerëzve që jetojnë në diasporë, sidomos tash në kohën e verës, do të ishte mirë që të intervenohet. E dimë se si komune e keni të kontraktuar me “Zuka Kompani”, të paktën që të mbyllën ato gropa, sepse ajo rrugë ka nevojë për rivitalizim total. Po ashtu kam ankesë nga fshati

Shushtë, është fshati përpos Ballancës është fshati i vetëm që nuk ka kanalizim dhe është shqetësuese që gjitha ujërat e zeza derdhen në Moravën e Binçës. Po ashtu këtu asnjë metër tretuar nuk është shtruar, 33 nxënës vijnë në mësimin, disa në Kabash, disa në Binçë dhe shpesh janë të rrezikuar nga njerëzit që vinë me shpejtësi të madhe nga Samakova, prandaj kërkojmë që atyre banorëve të ju rregullohet trotuari. Po ashtu po më gëzon fakti ma në fund, pas 6 viteve pasni marr masa për operatorin ekonomik në lidhje me asfaltimet e dobëta që po bëhen. Më lejoni të ju rikujtoj, se në vitin 2015/16 është shtruar rruga e Terpezës dhe rruga e Lubishtës në vlerën ma shumë se 160 mijë euro, totali 300 mijë euro dhe pas një jave kanë filluar me i harruar. Këtu duhet me bërë një hetim. Kam bërë kërkesë për qasje në dokumentet publike për pranimin teknik, pranimit teknik është bërë i përkohshëm, ndërsa kur kanë bërë kërkesë për pranimin përfundimtar nuk ekziston, mu ka përgjigj Zyra e Informimit, është shqetësuese që taksat e qytetareve nëse do të mbani mend për diçka është për asfaltime dhe riasfaltime brenda dy muajve, prandaj ku po shkojë taksat e qytetareve, kemi kompani mbikëqyrës për punë, kemi kompani projektuese, kemi inxhinjerët e komunës, pse nuk po i kryejnë detyrën e tyre.

z.Remzi Salihu: Nuk e pata ndërmend të kyqem në këtë temë, kam pritë se nga Drejtoria për Financa të mi sjell faturat që kam kërkuar nga mbledhja e kaluar, por siç po e shoh nuk janë, nëse janë, kërkoj që të mi japin, por nëse nuk janë kërkoj që të kem shpjegim pse nuk i kanë sjell ato fatura, dikush ndoshta thotë prapë u bë bajat kjo temë çdo mbledhje, por unë po e përsëris një thënie latine, përsëritja është mend e studimit. Edhe punimet e rrugës fushore në fshatin Remnik, pyes se a është përfunduar ky projekt apo është ndërprerë dhe nëse nuk është përfunduar pse është ndërprerë, arsyeja.

z.Bekim Azizi: Për këtë seancë kemi pas kërkuar prej drejtorit të Financave, nëse nuk ka harruar, ka pas me i sjell disa dokumente që janë bërë do investime në parkun në Terpezë, kanë pas për këtë seancë me i sjellë. Po e shoh se nuk i ke pru, isha lidh për këto punimet që po bëhen prej rrugës së Smirës deri në Viti, në çështjen e trotuarit që po shtrohet, nëse ju kujtohet, kuvendi ka pas miratuar një plan të mobilitetit dhe në planin e mobilitetit është paraparë një shtegë për biçikleta. Unë mendoj se është kanë shumë ma mirë që ti përmbahemi atij plani të jetë edhe një shtegë për biçikleta, se ai nuk ka qenë shumë i kushtueshëm që të lidhet kjo pjesë, se është shumë e rrezikuar prej numrit të madh të biçikletave që vozitin për shkak të afërsisë që e lidhin me Vitinë. Mirëpo, na miratojnë plane dhe ato plane nuk kanë të bëjnë ose nuk i zbatojnë ato plane, njëjtë sikur nuk e kemi zbatuar planin e mobilitetit që u kanë edhe për qendrën e Vitisë, që në qendër mos të ketë qarkullim të automjeteve. Edhe atëherë kemi dhanë shumë vërejtje, i kemi prua ekspertet prej Prishtine, mirëpo ai plan përveç taksistëve që ju janë bërë disa vende kurrjë tjetër nga ai plan nuk kemi aplikuar. Unë po themë edhe njëherë, se ajo pjesë ka shumë nevojë për një shteg të biçikletave. Kisha bërë pyetje, asfaltimi prej Sadovine deri në Dardani. Na e dimë se janë ndërprerë punimet prej qytetareve, se nuk janë kryer punimet në formën që është filluar të bëhet një zgjerim i rrugës në gjashtë metra deri në hyrje të Sllatinës, janë kryer punimet dhe pjesa tjetër ka mbi një vite që është gërryer asfalti dhe nuk është bërë asgjë. Kur do të vazhdojnë punimet, se mendoj është e padrejtë me i lan njerëzit për një vit në atë gjendje.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: Nga Zyra për Informim janë duke më informuar se ka tendenca nga këshilltaret komunal pa dashtë me ja përmend emrin, që të ndikoj te përcjellësi i seancës që mos ta bëjë transmetimin, e lus operatorin i cili e ka kontratën që ta përcjell seancën ashtu si e parasheh kontrata.

z.Basri Sylejmani: Unë kisha me u ndal pak te kolegët e mi, të cilët e ngritin zërin vetëm për keq, asnjëherë nuk i shohë për të mirë që e ngritin zërin. Po flas për fshatin Sadovinë, aty asfaltet që janë shtruar, kanalizimet që janë bërë, unë vet e kam ndërpre kanalizimin, vet e kam ndërpre urën tu ndërto në Sllatinë, vete i kame nderru do sene në Sadovinë, ju nuk punoni asgjë, veç i shikoni të këqijat. Dilni ndërprerja tenderin, thuj nuk është në rregull. Ka ardh të Shtunën me e bë kanalizimin në Sadovinë, ja kam ndërpre, se e ka fillu gabim, asnjë asfalt që është shtru vitin e kaluar ne Sadovinë, nuk është dëmtuar. Hajdeni këshyrne, as një kanalizim su dëmtu, sepse e përcjelli, dal i shikoj unë punimet, as fusha e futbollit nuk është dëmtuar.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Nga seanca e kaluar e kame bë një pyetje për drejtoreshën e Arsimit, lidhur me sekretarin e shkollës së Smirës. Nuk e di, nuk kam marr përgjigje për këtë. Për

drejtorin e Shërbimeve Publike kemi një kërkesë nga një banor i fshatit Smirë, ngase një shaktë i kanalizimit është mbyll dhe aty është bë si vendi i pajtueshëm për nja tri katër shpija. Është fjala për Besnik Ukshinin, është te ura afër lumit që qon te varrezat dhe ai gyp e ka qit ujin krejt jashtë, e ka mbulu një bashkëvendës i joni. Komuna nuk është interesu, nuk ka ardhur hiq, edhe ne e kemi ndërpre punën e kanalizimit në Smirë nja tri herë, po nuk na kanë përfill, e kane kry pranin teknik. E di që nuk ka, po kanalizimi i Smirës ka mbet një far sherri kogjo i madh, sidomos për banorët, sepse ata jetojnë aty. Për ujësjellës nuk po flas sepse foli Zeka.

z.Rasim Terziqi: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Përsëri tema e fushës së Sadovines, një temë që për here me prekë, se ajo fushe i ka taku Pozharanit. E dyta, është duke u zhvilluar debat publik për menaxhimin e fushave ne Komunën e Vitisë. Këto fusha kush do me i fut ne menaxhim, po kjo po bëhet pikërisht për këtë fushën e Sodovines me e shti në menaxhim të komunës, po nuk ka me mujt, sepse besoni që kam informacione të sigurt, se kryesia e KF “Vllaznia” ka me ngrit padi ndaj Komunës se Vitisë për këtë çështje. Ju siguroj, sepse kam informacion të saktë. Fusha “Ibrahim Kurteshi” kurrë nuk është bë, nuk e di ku është kuqit puna, beso të ish kanë mu shtru asfalt ish kry moti. Edhe doktoresha e ngriti çështjen e rrugës, atje te parku. Paramendo tash ishin tu dashtë me e renovu rrugën 200 metra, rrugë kanë be prerje 30 vende për me e renovu. Po 200 metra, prishe rregulloe krejt, sepse nuk riparohet, sepse është demtu shumë. Kjo rrugë me mirë është që me e rregullu krejt atë rrugë, edhe kërkesën e kam pas bë që me e rregullu kanalizimin aty, se po bëhet ujë e uji po e shkatërron asfaltin.

z.Taulant Haxhiu: Te nderuar asamblist! Para se me fillu me pyetje, jam ka e shoh që lista për nënshkrime që e kemi, që e marrmi gjithmonë në fillim të seancës, hala nuk ka ardh, po unë ju garantoj të gjithë opozitën, nëse ne marrmi naj vendim për me e braktis seancën, e nëse këta nuk e binë listën për me i nënshkru pagat kush del jashtë, unë ja jap pagën vete personalisht, sepse këta janë tu e bë qëllimisht. Unë po e shof që po bisedohet shume për asfalt. Unë kisha pas dëshirë me ditë, që kompania “Bageri” që po i kryen krejt punët, sipas informacioneve që i kam, ky është mik i kryetarit Sokol Haliti. Po du me ditë edhe njëherë, se kush është kompania “Bageri”, çfarë lidhje familjare ka me kryetarin Sokol Haliti. Për asfaltin në rrugën e Pozharanit, unë kam kërkesa, unë banoj në atë rrugë, në atë rrugë ka fillu edhe bari të del përmbi. Kështu që, është mit që edhe aty të intervenohet dhe të shikohen rrugët gjithmonë jo ku ka interesa vetëm pushteti po të shikohet rrugët në të gjithë qytetin e Komunës së Vitisë, unë kame kërkuar për urën në dy seanca, për shkak që e keni pas pak agjendën me të ngjeshur, unë kam kërku prej fillimi te ura edhe njëherë ta di shifrën, se ka ka ardh ajo 219 mije euro, at moment që unë e kame cek këtu në seancë. Qytetarët me kanë thanë, është mirë me dite komplet drejtorit z.Ramiqi se ai është e nalm. Edhe njëherë, të jeni pak me mu me të saktë, se unë nuk i la senet ne gjysmë, i qoj deri në fund.

z.Samet Idrizi: Të nderuar të pranishëm! Unë dua ti ngris dy çështje. Gjate kohës kur po shtrohet trotuaret, vija po ndahet prej asfaltit që ka qenë me herët e po mbushet aty me beton ose me asfalt dikune 10 deri 20 centimetra, dhe aty po mbetet pluhur e po del bari ne rrugën ku unë jetoj, rruga “Elvi Demiri”. Dje më ra rrugës Mogill-Viti, ish rrit bari aty bukur shumë, kishe vend deri gjysmë metre edhe në rrugën në Skifteraj është mirë masi jemi tu punu edhe në KAB, me parapa vitin e ardhshëm, ka edhe shume rrugë tjetra ku kryesit e punës po e lan shumë keq. Maspari edhe për shnet keq po edhe për estetik. Kështu që, ju kisha lut me parapa vitin e ardhshëm dhe ajo mundet me kushtu 5 mijë deri 10 mije euro me i riparu krejt ato lëshime që janë bë. Në Viti, këto dy tri vitet e fundi janë mbjell shumë dru dekorativ dhe tani është nxehtë, kane fillu shumë mu tha dhe po thahen. Kështu që, është mirë me mujt ato dy tri here bile me se paku me gjet një cisternë, “Hidromorava, ka cisternë, me marr në huazim, me mush ujë në “Moravë” dhe me me u kujdes për ato bime.

z.Ali Bajrami: Unë desha ta bëjë një pyetje apo ta ripërsërisë për Drejtorinë e Arsimit qa e kam shtruar ma herët, qa i përket çështjes së nxemjës qendrore në pesë shkolla të Komunës së Vitisë, që ka qenë projekt i ministrisë. Një falënderim për punën e mirë që është duke u bërë, shtrirja e gypit Germovë dhe Gushicë , ajo se do ta potencoj është kanali i famshëm në Skifteraj, që kam qenë vet e kam parë që është hap dhe është bërë një punë shumë e mirë, kam menduar se ti Mirlindë do ta potencosh, por nuk e bëre.

znj.Liridona Bislimi: Kam një kërkesë nga Këshilli i Fshatit Drobesh, gjithashtu edhe nga Zyra e Veteraneve dhe Familjeve të Dëshmoreve, që palestra sportive që është duke u ndërtuar në fshatin Drobesh, të emërtohet me emrin e dëshmorit “Muhamet Muharremi”. Familjaret, këshilli i fshatit dhe banoret e fshatit, e kanë bërë si arsyetim, për shkak se në fshatin Drobesh për dëshmoret nuk është flitë asnjëherë. Shkolla e vetme në fshatin Drobesh është paralele e ndarë nga Vitia dhe po mendojmë se është adekuate se palestra ta merr emrin e këtij dëshmori, prandaj unë kërkoj prej ekzekutivi, që të merret parasysh dhe të konsiderohet me seriozitet. Gjithashtu në fshatin Qifllak kam qenë e kam vizituar, kishin bërë ankesë vazhdimisht për një rrugë e cila para dy jave kishe filluar të punohet. Kjo rrugë që ka filluar me u bë një të mirë është tu e bë a 100 të këqija. Administratori kishte bërë vazhdimisht ankesa, e kish ndërprerë punën, tash kjo kompani që ka filluar me shtruar rrugën kanalizimet i ka dëmtuar komplet shaktat dhe mundet me u shfaq ndonjë sëmundje prej ujerave të zeza. Gjithashtu edhe për stadiumin “Ibrahim Kurteshi” në Pozheran si qëndron puna, që 1 vit e gjysmë kanë filluar punimet, është ndërtuar vetëm objekti i jashtëm si zhveshtore dhe për shumën që ma kanë treguar mua që është dhënë, është shumë. Ju kisha lutë që të bani diçka, se për rininë pozheranase është shumë me rendësi me u rregulluar ky stadium.

z.Sejdi Emini: Po e filloj edhe unë te uji, mirë është bërë se kaluan qe 6 vite edhe ka qenë e domosdoshme. Ajo çka më shqetësoi pak, gypi mu duk i ngushtë, ndoshta i plotëson standardet, por për sy mu duk i ngushtë. Sa ka me i plotësuar standardet mbetet me u pa. E dyta, te gropat septike në shkollë, drejtoreshë, kur ka qenë edhe drejtori i mëhershëm e kemi një gropë septike para shkollës. Ajo tash është amortizu, vetëm ka mundësi të paraqes pasoja për nxënës. Kemi kërkuar disa herë, pse nuk bëhet nuk e di, kanalizimi vetëm ka ardh, mirë që ka ardh, ka mundësi tash shume lehtë me hekë prej gropës septike me lidhe me kanalizim, mirëpo tash në këtë kohë me këto standarde me pas gropën septike para shkollës, me të vërtet është e pafalshme. Na kemi ndoshta mu detyru vet me dal me mshel si banorë, sepse nuk e rrezikojmë fëmijën tonë, mirëpo ju me pak pune me pak përgjegjësi e kryni atë punë. Te pronat shoqërore, me të vërtet qysh ja kemi nis, ndoshta edhe si shtet kemi me lan komunën pa asnjë pronë shoqëror. Është e domosdoshme me marr një vendim dhe një qëndrim si kuvend komunal, që me ju drejtu qeveris që pronat komunale, qeto që na kanë mbet bile mos me I shit ma. Çka është ka ndodhë, një pronë janë tu e shit për një shume shumë simbolike. Në te ardhmen kemi me u detyru me ble me miliona, me krejt buxhetin që e ka komuna. Unë po mendoj, që është koha me marr një hap e me dal me një qëndrim me ju drejtu edhe ministrisë, që pronat në Viti nuk I lejojmë më u shit, boll janë shit, boll janë keqpërdor. Tash e tutje është fundi i kësaj të keqe qe po ju bëhet komunës. Kemi thanë që kemi më bë hetime të ambulanta ne Goshicë, beso që ka pas mjaft kohe me u bë hetimet, nuk kemi me leju me u mbyll ajo ambulant, sepse ka ekzistuar në kohërat më të vështira dhe ka shërby. Tash e kemi thanë me plotë përgjegjësi dhe prapë e thamë, nëse nuk keni mundësi, tregoni bre, ne si banor dy dhoma kemi me I rregullu vetëm që ta funksionalizojmë, se nuk mundemi me leju me e mbyll pas shume vite. Në vend që me u hap, tash mu mbyll, ajo nuk është e drejtë. Edhe një problem që po me shqetëson mu dhe qytetaret e Vitisë, janë këta lypsarët që po vinë pa adresë. Me të vërtet kanë zanë me u bë të bezdisshëm, nuk jemi tu mujt me dal me nejt taman si qytetar me e pi një kafe, duhet me marr masa, sepse mu po me duket që ata po vinë në mënyrë shume të organizuar dhe po me duket që janë tubë biznese me këtë far pune. Është mirë me marr një vendim me bashkëpunu me polici dhe me këshyrë adresën prej kahit janë tu ardh ata, dhe nëse ka nevojë me ju ndihmu në mënyrë institucionale, taman qyshe I ka hije, ama jo në këtë formë siç është, se kanë me u bë shumë e tepërt. Drejtoresh, semimaturantat, nuk e di unë, qysh e di ka pas një vendim që semimatura me u mbajt nëpër shkolla, miëpo fatkeqësisht disa janë privilegjua e disa ju ka cenu e drejta taman ashtu qyshe kanë pas dëshirë. Unë besoj që nuk duhet me leju me u diskriminu një shkollë ose një nxënës në raport me të tjerët. Kur merret një vendim duhet mu kanë i premë dhe për të gjithë njëjtë, se ata janë fëmijë. Po dëgjojnë shokët e tyre, nuk u kanë e mirë kjo që ka ndodhë.

z.Nuredin Lutfiu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kame një pyetje për drejtorin e Inspektoratit. Në seancën e kaluar kam bë një kërkesë që me dal në rrugën Mogill-Skifteraj, një posetë është shume afër rrugës, është

e rrezikshme për banoret, a është dal deri me tani kjo drejtori, e nëse nuk është dalë me e dhënë një afat deri kur mundet me dal inspektorati.

Drejtori z.Isak Sadiku: Sa I përket pyetjes për E-kiosken ne Pozharan, ajo ka qenë një investim nga USAID Amerikan, mirëpo mirëmbajtjen e ka tjetërkush. Jemi në dijeni që nuk është tu bë, e kemi një gabim teknik, besoj që shumë shpejt kanë me e rregullu.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pata disa pyetje. Sa I përket asfaltimit të rrugës Viti-Drobesh, është një projekt që realizohet në bazë të memorandumit të bashkëpunimit në mese të Komunës dhe Ministrisë së Infrastrukturës. Ju jeni në dijeni, se ka pas problem me këtë rrugë, me këtë projekt dhe për këtë arsye ne nuk kemi dashtë të marrim pjesë në një pune që ka qen e keqe, sepse ne e kemi pas monitorusin tonë në këtë projekt dhe në fund, ata janë detyru ne bazë të presionit nga komuna jone me e rehabilitu këtë rrugë si që shihet tani ka fillu puna. Ky është projekt I financuar nga Ministria e Infrastrukturës. Sa I përket të gjeturave të Zyrës Kombëtare të Auditimit, një prej rekomandimeve është edhe çështja e një të gjeturës së arsimit. Ata i kanë pa disa hapa tejkalus në raport me ligjet funksionale, rregulloret e komunës, lidhur me organizimin e mësimin joformal. Në mbledhjen e ardhshme të kuvendit komunal, do të diskutojmë për planin e veprimit, që me I eliminua këto të gjetura. Ne do t'i eliminojmë të gjitha këto të gjetura të auditorit. Patëm pyetje, kur fillon asfaltimi I rrugës Skifteraj-Stubell, vetëm që nuk ka fillu përzgjedhja. Më duket është bë procedurat e prokurimit, kanë shku në rregulle, kompania së shpejti fillon punën, Sa i përket ujësjellësit në fshatin Smirë, ky është një projekt i Qeverisë Zvicerrane, që implementus është CDI-ja. Ky projekt ka të bëjë me ujësjellësin e Smirës dhe të Verbanit. Unë e di që pjesa dërmuese e rrjetit të gypave është leshu në tokë, kurse sa për finalizim, sipas informacioneve që i kam unë, jam njoftu, që ky projekt do të përfundon se shpejti. Mirlinda pat pyetje për rrugën e Binçes. Kjo rrugë është e vërtet që duhet me u rregullu, që tri vjet e parasheh Ministria e Infrastrukturës këtë rrugë mu finalizu asfaltimi dhe zgjerimi I kësaj rrugës deri Viti- Binç- Korbliq dhe gjithmonë është mëndu, sipas Ministrisë së Infrastrukturës, që këtë projekt ta financon Banka e Zhvillimit Evropian për Ndërtim dhe Rindërtim, dhe sot e kësaj dite ministria nuk e kane marr fondin për financimin e plotë, sepse ky kushton mbi 2 milion euro, ndërsa ministria këtë vit I ka nda vetëm 50 mije euro, e ne me këto kemi mëndu, e kemi bë një projekt të vogël, që me fillu vetëm pjesa segmenti të rruga Viti-Shushtë, edhe kjo është ne fazën e tenderimit. Besoj që shpejt fillojnë procedurat e ekzekutimi të kësaj rruge, kurse sa i përket pyetjes nga Bekimi, për rrugën Sadovinë e Jerlive – Dardani, po kemi pas problem rreth kësaj rruge, jeni në dijeni ju, po deri pak dite e kemi marr zotimin nga Ministria e Infrastrukturës për mjetet shtesë të finalizimit të kësaj rruge dhe procesi I zhvillimit të rregullimit të kësaj rruge është në proces të tenderimit dhe se shpejti do të del fituesi që do ta implementon këtë rrugë dhe do të përfundohet rruga. Mjetet i kemi siguru nga Ministria e Infrastrukturës. Një pyetje ke nga Taulant Haxhiu, që ka të bëj me realizimi e urës tek shkolla e mesme. Dy here raportin e kame dorëzua ashtu qysh e keni kërkuar ju.

Drejtoresha znj.Fatbardha Emini: Përshëndetje! Sa I përket mësimin jo formal, ky mësim organizohet që nga vitit 2004 bazë udhëzimeve të MASH-it dhe është një praktik që ne të gjitha komunat veprohet njëjtë dhe është trashëguar vite me radh, po nuk e di këtë vit auditori ka gjetë disa zbrazësia, që besoj që do t'i rregullojmë nga fillimi i këtij viti shkollor. Sa i përket sekretarit të shkollës së Smirës, e dini që pozita e sekretarit është pozitë, shërbyes civil dhe procedurat bazuar në ligji për shërbyes civil I zhvillon Zyra e Personelit në Komunën e Vitisë. Janë kry të gjitha këto procedura dhe tani jemi ne procedure e ankimimit, deri sa te mbyllet kjo procedurë nuk mundet të fillon punën si sekretar shkolle. Kështu sipas informatave që I kam nga Zyra e Personelit, ende nuk është mbyll procedura e ankimimit. Sa I përket çështjes se nxemjeve në pesë shkollat të projektit të evidencës së energjisë të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, vitin e kaluar është bë projektimi I këtyre pesë shkollave, ndërsa besoj që këtë vit edhe do të përmbushet planifikimi I këtij projekti. Sejda e tha për gropën septike në Goshic, e kam pa edhe vetë, besoj që shumë shpejt gjatë këtij pushimi verorë do të bëhet përgatitja e shkollave dhe kjo pjesë të rregullohet. Semimatura, e dini që me vendim edhe me udhëzim administrativë, edhe pse aty është një përjashtim, nëse shkollat nuk kanë kushte komunale e mbajt semimaturën ne shkolle dhe gjatë vikendit, për shkak se këtë vit kemi pas numër me te

madhe të orëve të humbura dhe sipas informative që I kam, asnjë semimaturant nuk është mbajt jashtë objekteve shkollore pa pëlqimin e drejtorive.

Drejtori z.Nexhmedin Jakupi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Sa I përket shqetësimit rreth rrugicës afër xhamisë ne Pozharane, është e vërtet se ai segment I asaj rruge është dëmtua. Ne e kemi evidentu e kemi planifiku dhe I kemi dhënë detyrat kompanisë e cila merret me mirëmbajtjen. Besoj që shumë shpejt do të rregullohet ajo pjesë. Si shqetësim I dytë, u ngrit për rrugicën afër urës ku kthehet për te varrezat. Nëse është fjala për këtë, ne kemi intervenu aty para një muaji, ku e kemi ndërru një gyp 23 metra dhe katër puseta I kemi pastru edhe I kemi vendos kapakët e ri. Për tjetërkund nuk e di që ka problem, edhe pse kemi intervenu në Smirë.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sa i përket raportit të auditorit, atë do ta sjellim ne seancën e radhës. Çka na gëzon fakti, nota e marrur e lart kundër atyre gjetjeve, ne e kemi bërë një plan të veprimit që me i tejkalu këto të gjetura. Njazia tha keqpërdorim të parasë publike. Nga profesioni jemi koleg, unë kurrë nuk e kisha përdorur këtë termë, po këto janë mendime të ndryshme, mirëpo qeveria e udhëhequr nga kryetari Sokol Haliti, po ju thotë kompanive stop ma se duhet të shtrohet kualitetit, sa të jete në kontratë. U ngrit një shqetësim për CARITAS-in tek çështja e pagës. Në momentin kur është konkurs publik, ku është theksu paga sa duhet ne muaj me i kajt, ajo është dëshirë e saj, aplikon dhe nuk mundet me bërë asgjë në atë drejtim. Ekremi pat pyetje për kryqen në gypin kryesor, që dy javë merrem me këtë problem, kame insistu shume me pas takime, tash e kemi një kontest për shkak se kompania implementuese kërkon pune shtesë, ingjinerat e “Hidromoraves” i kane thanë jo, se diçka që nuk ka bërë këtu e kemi shti me kry pune shtesë dhe duhet me ulë. Kysmet nesër planifikoj me u taku, gypi është plotë ujë, përdoret dikun dikun, po sipas ingjinerave ende nuk është testu që me i arrit ato bart që un nuk e di, po duhet mu testu. Pranim teknik ende nuk ka. Sa i përket pyetjes për kompensimin e dëmeve, nuk e di a i kanë pranuar kompensimin e dëmeve në Komunën e Vitisë. Detyrë e jona ka qenë me i mbledhë me shifra me i përcaktua e me ja qu qeverisë, tash nuk e di a e kanë aprovu ata për disa komuna të tjera. Rruga e Binçes është edhe kërkesë kryetarit të Shushve për kanalizim dhe tretuar, megjithatë nuk po mundet mu kry krejt, ju kemi dhënë përparësi vendeve që kane frekuentim më të madh të nxënëseve, pa dash, pa i anashkalu edhe Shushë. Rruga në Remnik, rruga fushore nuk është ndërpre po është kry faza e parë dhe tash vazhdojmë me fazën e dytë. Bekim, plotësisht pajtoj me shtegun e biçiklistave, ndoshta është edhe formë evropiane që duhet me ja mësy ne sa kemi me mujt ndoshta me u pas pyet unë, njërin pjese e kisha nda me një vij dhe e kishim bërë shteg të biciklistave. Klubet e shoqatat kane të drejtë me bërë padi nëse mendoj që ju kane cenu te drejtat. Po megjithatë Rasim nuk po du me e shfajesu kërkan rreth stadiumit të Pozharanit “Ibrahim Kurteshi”, po flas tani të kisha marr vetëm me pa kurrë nuk i kishe thanë këto fjalë, as ti as të tjerët me i pas pa përpjekje e tona të cilët i bëjmë në at drejtim, jo vetëm të mija po të gjithëve, tu e përfshi edhe kryesuesin e kuvendit. Nuk e di sa herë kemi shku ne Prishtinë për këtë çështje, nuk e di sa herë ma kanë bërë qefin për këtë çështje, po megjithatë unë mendoj që në aspekt ligjor jemi mirë, jemi në fazën që nuk e kemi zhblloku ende, jemi tu bërë përpjekje e besoj që kemi me e zhblloku. Nuk e di, asnjë informacion nuk e kam qe firma “Bageri” është familjar i kryetarit, këtë nuk e di dhe jam i bindur që nuk është familjar. Sameti e ka ngrit një çështje shume të rëndësishme. Unë konsideroj, kjo mënjanimi i këtyre pjesëve prej trotuarit deri te asfalti duhet ne aprovim të buxheti si çështje me shti, ndërsa me urgjencë e di që e kemi ngrit edhe ne në ekzekutiv çështjen e ujitjes se bimëve dekorative, është mira se përveç investimeve që janë bërë ato dru do të shërbejnë masandej edhe për të gjithë qytetarët e Vitisë. Respekt për të gjithë dëshmorët, i vjen rendi të gjithëve, ne e kemi formu komisioni për emërimin dhe riemërimin e rrugëve, në rast që është nevoja formojmë edhe komision tjetër, sepse kemi shumë dëshmorë, tu e propozu njërin e lëndojmë tjetrin, po, po kërkoj të kemi kujdes sepse është çështje e ndjeshme, duhet me dit që e kemi vetëm një palestër të ndërtuar e duhet të bisedohet ne komision kjo çështje. Sejd, nuk mu bërë pyetje për gypin që me e pa sa banor mundet me i furnizu. Te pronat shoqërore nja shtatë a tetë here i kemi qu, nuk kemi lan derë pa trokit, kërkesa pa qu tu thirr asociacioni i komunave me iniciativën e kryetarit të komunës. Në disa komuna kanë marr një vendim, ja kanë dërgu kryeministrit, e gjykata ato vendime i ka shpall kundërkushtetues. Në rast se kjo çështje nuk bëhet ne nivel vendi, nuk ka asgjë, plotësisht pajtoj që pika me e dobët

në Kosovë ka ndodhe pas luftës, është çështja e privatizimit të pronave, fabrikave, po megjithatë e kemi këtë gjendje, ne si çështje mundemi me ngri dhe mu pajtu të gjithë grupet, me bë një tekst me dërgu me qeveri. Shumë shqetësuese dhe çështja e lypëseve Sejd, e kemi bisedu në KKSB, e kemi paraqit si shqetësim dhe me të vërtet është shqetësuese, po tash se ku e kanë burimin ata, ka po vinë, ndërsa unë personal e kame bindjen time, mirëpo nuk po e thamë atë bindjen time, të Hënën e kemi KKSB-në, do ta ngris si çështje prapë.

z.Nijazi Isaku: Unë pyetjen e bëra Drejtorisë së Arsimit për të gjeturën e auditorit, e ku auditori ka konstatu që është shkelje ligjore. Cili është hapi, a keni me ndërmarr diçka që me e ndërpre këtë shkelje ligjore. Çka po behet me ata nxënës që i kane marr diplomat deri me tani, ndërsa për rrugën, unë nënkryetar po pajtojmë që po flasim për para publike dhe jemi këtu me e ruaj paranë publike, e nëse qaj projekt është 341 mije euro, kjo duhet mu marr seriozisht. Janë vetëm dy rrugë, ajo e Pozheranit për të cilën nuk e di a është shtru kjo rrugë, sepse aty parashihet shtrurja e asfaltit. Nëse nuk është bë kjo, unë mendoj që është keqpërdorim i parasë publike.

znj.Liridona Bislimi: Ne mbledhjen e fundit të KPF-së, ne fund e përmenda, që disa informata i kam kërkuar, pastaj shkova në Zyre të Kryetarit, aty e kame takuar Fatlumin, ku kam kërkuar, paraprakisht kam fol edhe me Ilirin, thash kam ardh për me i marr dy informacione. I thash me mi sjell këtu, unë nuk po e shoh që nuk i keni sjellë ato dy informacione, informacionet kanë pas të bëjnë me parkun në Budrikë dhe për Listën e fermerëve që kanë pasur dëme për vitin 2019.

z.Ekrem Abazi: Për të gypat e ujit, po me vjen shume mirë, nuk e kame ditë që një kapacitet i ujit të koka tu ardh nga ai gyp, po punëkryesi në atë moment që e ka lëshuar ujin, qysh kam informata unë, kanë kup gypat 5-6 vende. A i ka ditë punëkryesi, çfarë kapacitetit të ujit ka me kalu në ata gypa dhe ka deshtë me qenë shumë i përgjegjshëm, a e keni dënuar atë punëkryes që e ka kry punën e dobët me at kapacitet shume të vogël kanë pëlçit gypat, po tash kur ti jekmi këta gypat kancerogjen që kemi thanë njëmijë herë, a guxon me e lëshu ujin me shtypje më të fort, apo kemi me mbet hala ma keq se sa që jemi për ujë. Liridonën plotësisht e përkrahi për me e marr palestra, emrin e dëshmorit se ne jemi tu bë vaj halli për neve edhe ne dëshmorë bëjmë dallime, dëshmori është dëshmor, kontributi edhe lloj lloj, por dëshmori është dëshmor, është punë e kryeme edhe masi i përket qati lokaliteti, u kanë mënyra më e mirë që ai palestër me pas emrin e ati dëshmori të ati lokaliteti, po këtë nuk e bëni, se nuk e ka familjen e madhe, nuk pritni vota prej asaj familje qyshe mendoni ju dhe kjo nuk kalon, këtë e bëjnë të gjithë partitë. Linda tha vetëm të Shushtë ka mbet pa kanalizim, po ta përsëriti, asfalti po shtrohet e kanalizim nuk ka të Viva, nuk ka të pumpa të Alidemtë.

znj.Mirlinda Sadiku: Ushtues detyre e keni marr detyrë, e di që keni bë një rrokat e di që para teje ka qenë një zojnë, tash je ti aty. Në seancën e 30 gusht 2018 është diskutu për demet, e kame informacionin e saktë që është bë ne kulturat bujqësore, me lejoni të ju përkujtoj, janë dëmtu 139 hektar me pemë dhe perime dhe në fshatin Skifteraj janë 140 hektar me kulturën e shalqinit, kurse si numër total i dëmtuar i fermerëve janë 53 fermer. Vendimin e qeverisë e kam pa, ma ka tregu Vetoni. Në seancën e ngushtit qytetarët po pyesin a ka, a do të ketë apo mos me mbajt ymyt hiq.

z.Taulant Haxhiu: Nënkryetar, nuk besoj që foli diçka me tendenca. Unë kam marr informacion, që kompania “Bageri” ka lidhje familjare me kryetarin Haliti, po në seancën tjetër do ta bëjë emrin e pronarit. Kosova ëshë e vogël, njëfemi të gjithë në mese veti dhe e shofim se çfarë lidhje familjare ka Sokol Haliti me kopanin “Bageri”.

z.Sejdi Emiri: Sa i përket nxemjes qendrore në shkollë, përgjigjen nuk e murrëm, po du me ditë a kemi nxemje këtë vit apo nuk kemi. Po flitet për digjitalizim në shkollë, e nuk kemi nxemje, nuk po pajtohem unë me këtë sen. Te dëshmorët, me të vërtet është punë e ndjeshme, ju që jeni në mandatin e dytë dhe e dini që në mandatin e parë është diskutu edhe për një dëshmorë që e mban shkolla jonë në Goshicë, duhet me pas guxim me fol haptas. Tash e dini që ai emër është pak i kontestuar, edhe pse ligjërish qëndron, mirëpo komunitetin në të cilin jetojmë, nuk e ka pranë, nuk ka pllakë, nuk ka bust, nuk ka ditë të shkollës. Kemi kërku në mënyrën me njerëzore me dal prej kësaj situate në të cilën e ka kriju pikërisht politika edhe atë e ka kriju politika. Ish drejtori i Arsimit e ka marr at barrë me kry at punë. Kisha kërku prej ish drejtorit me e marr fjalën për këtë.

z.Nuredin Lutfiu: Kërkoj prej drejtorit përgjigje për rrugën Mogill-Skifteraj për pusët që janë afër rrugës.

Drejtori z.Skender Ahmeti: Përhëndetje për të gjithë, faleminderit për pyetje! Këtë çështje do ta përcjellim, po kjo është çështje ekskluzive e policisë dhe e KKS-së që do ta përcjellin besoj që do ta diskutojnë këtë ne do ta vizitojmë ta shofim si është gjendja dhe do të marrim masa.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Ekrem, unë nuk e kundërshtova propozimin e Liridonës, mirëpo është komisioni, e të ja lam punën atyre me vendos. Sa i përket gypit, i kanë eliminu ato defekte që janë paraqit, qashtu me është raportu mu, a do të bënë shtypje që po e thu ti, unë besoj që për atë është pranimi teknik, kanë me e provu para se me bë pranimit teknik.

z.Jakup Demiri: Drejtoresh, rasti I sekretarit të shkollës në Smire, nuk është në pyetje vetëm ky komision I tanishëm që e ka vlerësua, po në vazhdimësi kjo punë ka qenë problematikë. Në shkallën e dytë e të tretë edhe ne gjykatën supreme e ka të humbur kandidati që e keni përzgjedh, tash edhe ky komision është problematik.

Drejtoresha z.Fatbardha Emini: Unë ju përgjigja me ato informacione që i kamë nga Zyra e Personelit.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit të gjithëve për kontributin që dhatë. Për seancën e gjashtë të rregull të Kuvendit Komunal të Vitisë, kemi parapa këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Kuvendit Komunal të Vitisë.
2. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2020-2021(Pa rekomandimin e KPF-së) .
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregulloren mbi themelimin dhe strukturimi e asamblesë komunale të fëmijëve.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregulloren për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunale Miqësorë për fëmijë
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik propozim rregullore për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së subjekteve të biznesit në Komunën e Vitisë
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetori të punës së Kuvendit komunal të Vitisë për vitin 2020.

A ka dikush rreth rendit të ditës.

z.Nijazi Isaku: S i përket rendit të ditës, te pika e dytë, Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2020-2021 (Pa rekomandimin e KPF-së), kjo pik nuk është votu ne KPF. Ju e keni sjell si pik të rendit të ditës, po ne e konsiderojmë që keni bë shkelje të afateve të përcaktuara nga qarkorja buxhetore 2020-2022. Po e citoj qarkoren buxhetore që është caktu nga ana e ministrisë, komunat janë të obliguara të përgatisin kornizën afatmesme buxhetore komunale për vitin 2020-2022 dhe ta aprovojnë ne Kuvendit Komunal deri me datën 30.06.2019, që I bjen tani jemi në muajin Korrik. Është shkel afati që është përcaktu nga ana e ministrisë lidhur me aprovimin e kornizës, andaj ne si Lëvizje Vetëvendosje nuk do të bëhemi pjese e kësaj shkelje dhe ne do e lëshojmë seancën ne shenj proteste për këtë shkelje nga ana e juaj.

z.Bekim Azizi: Meqenëse pika e dyte është pa rekomandim të KPF-së, për një rrjedhojë normale të këtij kuvendi, kisha kërku që te heket nga rendi I ditës, që mos të behet një praktik e keqe që naj keni sjell edhe ne seancat e kaluar, po të vazhdojmë me praktika të mira, sepse ligji thotë, që pikat shkojnë ne kuvend me rekomandim të KPF-së.

z.Ali Bajrami: Është e drejtë e juaj të merrni vendime, mirëpo mu bë pengesë KPF-ja për punën e kuvendit komunal, nuk po me duket e kuptim. Për rregullaritet dhe ligjshmëri është ministria përkatëse që vendos nëse ne e kemi bë një vendim të kundërligjshëm dhe shkon ky propozim që ka ardh pa rekomandimet e Komiteti për Politikë dhe Financa, ajo është kompetente a është ne rregull apo I kundërligjshëm ky vendim. Prandaj nuk është mirë të instalojmë kesi politika të dëmshme që janë në dem të komunës dhe qytetarëve të Komunës së Vitisë.

z.Ekrem Abazi: Unë nuk jam ka e di a ka ardhë naj ligj me frik që se kam pa unë, vetëm ligji I mëparshëm I pushtetit lokal thotë: “çdo pik kalon përmes KPF-se”, dhe tjetra: “KPF e rekomandon me shku pikat në kuvend”. Nëse ka naj ligji të ri që se kemi pa ne, tregona, përndryshe edhe unë dal nga kjo seancë.

z.Jakup Demiri: Sa I përket veprimeve që I bënë opozita, janë veprime tona që nuk kemi nevojë me ju pyet juve hiq. Raporti që u ardh nuk ka asnjë rekomandim që e kemi dhënë ne dhe përveç kësaj ka është shkelje ligjore.

z.Samet Idrizi: Unë vërtet shpesh po gjendem para një situatë jo shume të këndshme, jam me I ndjek politikat parimore tu e respektu ligjin pa dashtë me u bë ne kra te Ali Bajramit, që tha është ministria që e bënë ligjshmërinë e vendimit, po kam qef me e ndegju një arsyetim prej pjesëmarrësve ne KPF, sugjerimet e tyre cilat kanë qenë dhe mangësitë e pushtetit aktual, ku është dallimi, pse nuk kanë mujt me e kalu këtë ne mënyrë që me e kalu sot. Unë e pash pak këta të VV-së, kenë të nxitur, ndërsa me pëlqej parimi I Bekimi, I cili kërkoj prej kryetari të kuvendi që të tërëheket kjo pikë krejt dhe të punohet me seancë, ndërsa Nijaziu dashti të ika pa e dëgjuar mendimin e shefit të PDK-së. Kjo nuk me pëlqej mu. Pse, sepse VV-ja po donë me marr këtu primat për gjithçka, po me vjen shumë keq këtu që PDK-ja pak ka ra nënë ndikimin e VV-së. Unë nuk muj mu bë pjesëmarrës i këtyre skemave, unë at dëshmorin ne Drobesh e kame kushëri, e me shume se ti kam qef me ja lan emrin, ama një asambliste e VV-së del bënë propozime për poena politik, mos nxitoni, se perime këto veprime janë të ulëta.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Ekrem qaj ligj është, nuk ka ndryshu, thotë: “me rekomandim nuk e ndalon”. Na jemi obligativ me I besu shkalles së dytë, e cila është ministria, e ju nëse mendoni që çështjen të cilën po e ngritni ju është ne anën e juaj, e formojmë një komisioni, nesër shkojmë ne ministri, e pyesmi, bindu që kanë me thanë që e kemi të drejtën edhe pa rekomandim. Kryesuesi është konsultu me mu dhe e kemi qu pa rekomandimin e KPF-së. Nijazia tha e keni kalu afatin ligjore, me vjen keq se kryesuesit I vjen keq me thanë këtë, e dimë që e kemi kalu afatet ligjore, po kryesuesi e ka pas një problem shëndetësor dhe ka qen në operim të kryesuesit për të cilën beson që edhe ti e dinë këtë, na jemi njerëz, kemi sëmundje.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: Rreth sqarimit, faleminderit nënkryetar që e sqarove rastin tim. Në debatin publik të cilin e ka organizuar KPF-ja, kanë qenë prezent Jakupi edhe Liridona, dhe unë kam pirë kafe me ta, me një mënyrë ju kam treguar dhe do të vonohet seanca për shkak të gjendjes shëndetësore dhe një po ju them, momentin se kam mbërrë nga spitali ka qenë e premte, e kam thirr Ilirin, dhe nga shtëpia e kam caktuar mbledhjen vetëm me mund me I zanë afatet, ndërsa sa I përket aspektit ligjorë, a kemi të drejtë a nuk kemi të drejtë, nënkryetari e shpjegoj. Kam qenë dje në MAPL, ka qenë edhe ministria aty, ka qenë edhe sekretarja permanente dhe me monitoruesin e Kuvendit Komunal të Vitisë, I cili është Kujtim Aliu, e kam sugjeruar, I kam treguar për këtë çështje dhe e kam marr rekomandimin e tyre.

z.Njazi Isaku: Më vjen keq për sëmundjen që e ke pasur dhe je prej njerëzve që të respektoj, kështu edhe nënkryetar harroje ata, se na nuk jemi kundër vlerave njerëzore, por unë po lidhem me një dokument që nuk po dua unë me u bë pjesë e shkeljeve, tu e ditë se është shkelje, nëse nuk është shkelje, atëherë rri ju vazhdoni votone, edhe tu ditë se e shkelim ligjin, na nuk mundemi me vazhduar me nejt ne seancë. Në lidhje me Sametin, tash ma shumë ju gjujt Vetëvendosjes. Unë po mendoj se këtu na jemi opozitë, kemi pas veprime të bashkuara si opozitë për bashkime të mira për të mirën e qytetareve nuk besoj se është bërë vegël e askujt, se secili prej neve I kemi programet e tona bindjet tona edhe diskutimin në kuvend. Qysh e bëjmë është çështje, e jona. Tash ty a të pëlqen a jo është krejt problem tjetër, por na këtu diskutojmë edhe me argumente edhe me fakte, besoj se asnjëherë nuk kemi ngrit një diçka kur nuk kemi pasur fakte apo një bazë të asaj qe e kemi ngritur.

znj.Mirlinda Sadiku: Morra si obligim mi dhanë sqarim një ekonomisti, edhe pse e dinë plotësisht arsyen tënde, por megjithatë e di arsyen tënde, por po ti jap arsyet që I ka dhanë Lëvizja Vetëvendosje që kanë qenë shumë substanciale, shumë të qarta, por asnjë prej tyre nuk e kanë marr parasys. Këta po thotë tash I shtim rekomandimet, por kanë mund edhe kur kanë qenë në komitet, sipas kësaj kornize a e ke paraparë cilit sektor do t'i jepet përparësi, arsimit, shëndetësisë, sistemit të ujitjes. Na I kemi dhënë 17 rekomandime, asnjë nuk e keni marrë me shti, sipas kësaj kornize cilat investime kapitale nëse I shikon kornizat e vendeve tjera, kjo është ma e ulëta për sa i përket punimit të saj.

z.Bekim Azizi: Megjithatë unë mendoj se pikat duhet të diskutohen me qetësi. E di se edhe juve e keni marr për të madhe, disa ju ka ngulfat në fyt, por ju e dini se na nuk jemi për me I blloku proceset, ju e dini se nuk ju kemi bllokuar asnjëherë e ke filluar një praktikë të keqe kryesues, qe disa seanca ke filluar me sjell pika pa rekomandim të KPF-së, kemi pas konsultime që disa raste I kemi lejuar, por tu kisha lute përmbaju rekomandimeve ta mbajmë një klimë të mirë, por edhe të ju përmbahemi atyre qa ju shkruan Ligji për Vetëqeverisje Lokale kemi drejtë me dhanë mendime tona, secili. Kurrë Samet në jetën time nuk mundet me ndikuar dikush te unë edhe ti e dinë mirë, sepse I kam do parime, se pa qenë edhe në kuvend hiq I kam mbajtur e le ma tash, por kërkoja shumë thjeshtë, pa diskutuar shumë, nuk e ke rekomandimin për këtë pikë, largoje nga rendi ditës edhe vazhdojmë me seancë.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: Atëherë kush është me hekë këtë pike të rendit të ditës me ngritje dore ju lutëm? Me 11 vota pro, atëherë me votën e dyfishtë të timen mbetet si pikë e rendit të ditës. Pasi që nuk kemi korum, unë e ndërpres seancën për vazhdimin e seancës do ju njoftojmë me kohë. Atëherë vazhdojmë me punimet e seancës së ndërprerë të enjten për shkak që nuk kemi pas kuorum. Më lejoni të ju përshëndes të gjithëve që jeni sot në këtë takim të radhës. Një pjesë e opozitës është këtu një pjesë nuk është. Unë si kryesues i kuvendit i kam niftuar të gjithë për vazhdimin e seancës që do ta kemi sot. Kishte me qenë mirë që opozita të ju bashkëngjitet punimeve të kuvendit, se me një mënyrë e kemi votën e qytetarit dhe këtu jemi për ti trajtuar problemet e qytetareve, këtu jemi për ti trajtuar hallet e qytetarëve aq sa kemi mundësi. Tash pasi kemi kuorum të mjaftueshëm, vazhdojmë me punimet e seancës të seancën e ndërprerë të së Premtes, vetëm se KAB-in e kemi futur si pikë të rendit të ditës, neve na mbetet ti votojmë edhe pikat e tjera të rendit të ditës. A ka dikush rreth rendit të ditës? Urdhëro z.Samet!

z.Samet Idrizi: Unë Samet Idrizi nga sot deklarohej i pavarur për punën time që do ta ushtrojë tash e tutje si asamblist në Kuvendin Komunal të Vitisë. Dëshiroj ti falënderoj familjarët e mijë, shokët miqtë që më kanë mbështetur për këto dy mandate. Arsyeja ime është ato të cilat i ceka edhe në seancën e ndërprerë. Mua nuk po më pëlqen roli i partisë sime, e cila po bënë skenare me Vetëvendosjen, kështu që e konsideroj ma të dinjitetshme un tash e tjetër me dhanë kontributin tim këtu në kuvend si i pavarur falënderoj shumë koleget e mi të ish partisë PDK që që kam punuar deri me sot.

z.Rasim Terziu: Edhe unë për shkak të pakënaqësive që kam pasur rishtazi me Nismën Socialdemokrate dhe largimin e ministrit Bajram Hasani, pakënaqësia ime është shfaqur vazhdimisht te NISMA për mosbashkëpunim. I kam ftuar vazhdimisht, e kam ftuar ministrin e Arsimit që të vie ta vizitoj shkollën, nuk ka shpreh gatishmëri, edhe unë nga sot deklarohej, funksioni im brenda kuvendit të jetë si i pavarur. Falënderoj të gjithë ata se me kanë përkrahur, po unë gjithnjë do të jem në interesin e tyre qytetar, do t'i mbroj interesat e qytetareve të Pozheranit, se aty jam votuar më së shumti.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë si kryesues i kuvendit po e shfrytëzoj rastin të ju falënderoj të dyve për kontributin e dhënë. Kush është që të miratohet rendi i ditës me këto pika? Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 14 anëtar të kuvendit dhe me vota të gjithë të pranishmëve miratohet rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Kuvendit Komunal të Vitisë

A ka dikush rreth pikës së parë të rendit të ditës ju lutëm? Pasi nuk ka e hedhim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatoj se me 14 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim miratohet pika e parë e rendit të ditës.

Si pike të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2020-2021(Pa rekomandimin e KPF-së)

Ja kisha kaluar fjalën drejtorit rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Ibrahim Rama: Kjo pike ka të bëjë për KAB-in (Kornizën Afatmesme Buxhetore) për vitin 2020-2022. Edhe në KPF e kemi thanë unanimisht, edhe unë posaçërisht si përpilues i KAB-it. Është një fillim i dinamikës së përgatitjes së draftit përfundimtar të buxhetit për vitin 2020 dhe projeksionet për vitin 2021 dhe 2022, pra është një nder dokumentet ma kryesore që miratohet në kuvendin komunal dhe besoj që meriton vëmendje. Ky proces ka filluar me 15 Maj, atëherë kur në asamblenë komunale na ka ardhur qarkorja e parë buxhetore dhe na kemi filluar menjëherë me hapat ligjor që kanë të bëjnë me përgatitjen e draftit të buxhetit. Unë ma shumë nuk do të ju marr kohë, vetëm të ju tregoj se është një proces që merr mjaftë kohë, diku rreth 4 muaj për të përgatitur këtë dokument. Nuk kam diçka ma shumë të shtoj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Para se me hap debat, unë desha ta përshëndes kryetarin i cili na u bashkëngjiti në këtë seancë. Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

z.Ali Bajrami: Përshëndes të pranishmit dhe parafolësve ju dëshiroj suksese si asamblist të pavarur. KAB-in që e kemi sot në diskutim, është si dokument kryesor për funksionimin normal të Komunës së Vitisë për vitin fiskal 2019. Si dokument kryetari i komunës propozon kuvendit komunal që ta aprovoj KAB-in për periudhën kohore 2020-2022, pjesë përbërëse e këtij dokumenti është edhe Drejtoria e Financave për prezantimin dhe paraqitjen e të gjitha të dhënave. Sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), të hyrat I kemi nga të hyrat vetanake dhe grandet qeveritare, kurse indikator kryesorë ekonomik komunal është popullsia e Komunës, numri I bizneseve të regjistruara dhe numri I nxënësve. Ajo që vlen për tu cekur është, se në buxhetin për vitin 2020 kemi një rritje në

përqindje prej 7.95%. A është e mjaftueshme nuk është, por edhe vlera në para prej afër 1 milion euro nuk është e vogël, ajo që e cekti edhe drejtori kemi një zvoglim të të hyrat vetanake që është paraparë. Po mendoj me një punë dhe një angazhim besoj që do ta rrisim që këtë vlerë ta rrisim dhe është mire nëse arrimë ta rrisim, sepse të hyrat vetanake janë mjete që direkt mund të hynë në shfrytëzim në Komunën e Vitisë dhe ti kthehen qytetareve. Tjetër çka kisha cekë për vitin 2020, te tabela numër 6, viti 2019, bursa për student. Kemi pasur 45 mijë euro, 2020 është paraparë kjo vlerë të rritet në 50 mijë euro. Gjithashtu vlen të ceket se edhe në bujqësi subvencionet nga 33 mijë euro është paraparë viti 2020 janë paraparë 53 mijë euro. Nëse e marrim si buxhet për investime kapitale, kemi 18, 29 %, kjo shumë grande qeveritar është 1 milion e 772 mijë euro e 525 euro, kurse nga të hyrat vetanake kemi 478 mijë e 559 euro, që në total është 2 milion e 251 mijë e 84 euro. Nuk e kisha zgjatë ma tepër rreth kornizës afatmesme buxhetore, për fund për vitin fiskal 2020 kisha si propozim që prioritet ti jepet investimeve në arsim në objektet shkollore. Dhe nën 2, pas dëgjimeve buxhetore që do ti kemi për vitin fiskal 2020, të evidentohen dhe prioritet nëpër lokalitete të ju jepet projektet që I cekin dhe I potencojnë qytetaret e lokaliteteve të cilat mbahen dëgjime buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: E përshëndes edhe përfaqësuesin e OSBE-së, që na u bashkëngjijt tash në seancë. Dikush tjetër a donë ta merr fjalën ju lutëm?

z.Samet Idrizi: KAB-i, tani ma jemi në përpunimin e buxhetit për vitin 2020, megjithëse Aliu e bëri elaborimin ma të gjërë, unë vetëm kisha kërkesë të ju jepet prioritet ma shumë, sidomos kanalizimeve kudo nëpër Viti dhe nëpër fshatra dhe mundësisht të kursejmë nga shërbimet subvencione, shpenzime të tjera të rrymës të ujit dhe të bërllotut dhe të investojmë ma shumë në kanalizime, përndryshe mua më pëlqej se ka bukur një rritje të madhe buxheti i vitit 2020 në krahasim me vitin 2019. Besoj se këto kërkesat të mijat do të merren parasysh.

Kryesuesi z.Naim Pira: Nëse nuk ka, atëherë drejtor, kërkesat që i patën dy këshilltarët komunal do t'i merrni parasysh aty ku ka mundësi të implementohen. Atëherë mua më mbetet ta qes në votim. Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Faleminderit, konsideroj se me prezencën e 14 këshilltareve miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katërt kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregulloren mbi themelimin dhe strukturimi e asamblesë komunale të fëmijëve, dhe pika katër e rendit të ditës 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregulloren për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunale Miqësorë për fëmijë

Ju kanë nënshtruar debatit publik, ndoshta kishte qenë mirë me i përmbledh te dyja bashkë me një pikë, por unë sidoqoftë po ja kaloj fjalën nënkryetarit të bëjë një elaborim të shkurtër të këtyre dy pikave.

Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu: Pra, ju këshilltarë të kuvendit komunal, keni pas rastin me i pas dy Propozime rregullore të cilat janë të përgatitura nga zyrat e kryetarit të Komunës së Vitisë, fjala është për rritjen e performancës e cila duhet ta ketë, por duhet të kemi edhe një sistem, një qasje krejt tjetër edhe për fëmijët krijimin e kuvendit, themelimin e asamblesë komunale për fëmijë. Unë nuk do të hy në detaje të rregulloreve, për shkak se ju marr kohë dhe keni pas rast edhe me lexuar, prandaj ne duhet tu japim vizën këtyre rregulloreve për me kaluar në kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. Pasi nuk ka për diskutim, unë po i qes në votim dy pikat, 3 dhe 4. Kush është që të miratohen këto dy rregullore?

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik propozim rregullore për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së subjekteve të biznesit në Komunën e Vitisë

Ja kisha kaluar fjalinë zyrtarit nga Drejtoria e Inspeksionit rreth kësaj pike.

z.Bushat Zuka: Unë sot jam I autorizuar nga drejtori i Inspeksionit, z.Skender Ahmeti, për me dal para jush edhe me bë kërkesë për me na dhanë të drejtën që kjo rregullore të merr vizën nga kuvendi për me u paraqit në diskutim publik. Kjo rregullore është për organizimin e orarit të punës bazuar kryesisht në Ligjin e Punës dhe në

ligjet mbi tregtinë e Kosovës. Ma shumë nuk do të ju marr kohë, pas ka me shku në debat me qytetar dhe do të kthehet prapë në kuvend. Kështu që, nëse ka dikush diçka, jam i hapur për diskutim.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

z.Ali Bajrami: Nuk do ta zgjas shumë, pasi kjo rregullore do të shkoj në diskutim publik. Si propozim vendim që na ka ardhur prej kryetarit të komunës, është I qëlluar, se është koha e fundit që edhe në sektorin privat të vendosim rend, rregull dhe disiplinë të punës, sikur që e kemi në sektorin publik, se këto dyja kanë qenë shumë të shkepura njëra me tjetrën. Takimet e shuma që kam pasur me shumë punëtor, janë duke e pritur me padurim një miratim të kësaj rregullore, se edhe ata janë pjesë e kësaj shoqërie dhe edhe ata duhet ta gëzojnë të drejtën e pushimit. Në diskutim publik do të përfshihen të gjitha bizneset, besoj se do ta implementojmë.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: A ka dikush tjetër rreth kësaj pike të rendit të ditës? Nëse nuk ka, e hedhim në votim që të shkoj për diskutim publik kjo pikë e rendit të ditës. Konstatoj se me 14 vota pro shkon në diskutim publik.

Si pikë të fundit për sot kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetori të punës së Kuvendit komunal të Vitisë për vitin 2020

Është ndoshta hera e pestë apo e gjashtë si kryesues I kuvendit që kam qenë I vëmendshëm në aspektin e përpilimit të planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë dhe ky plan gjithmonë është miratuar me miratimin e buxhetit, dhe kësaj here unë e kam propozuar një komision I cili do të merret me hartimin e këtij plani të punës, ku me atë plan të punës do të inkorporohet edhe kosto buxhetore e cila duhet për kuvendin komunal për funksionimin e tij, sigurisht nëse na vjen udhëzimi I ri administrativ do të paguhet edhe komitetet tjera jo obligative do të kenë mëditje dhe për atë arsye unë e kam bërë propozimin që komision për themelimin e këtij dokumenti do të jenë të gjithë përfaqësuesit e grupeve parlamentare duke përfshi kryesuesin e kuvendit Ali Bajramin (LDK) , Mirlinda Sadiku (LVV), Bekim Azizi (PDK), Vehbi Rama (AAK), nga sekretaria Fatlum Demiri dhe një përfaqësues nga shoqëria civile. Po e hapi debatin, nëse ka dikush me diskutuar rreth kësaj pike, nëse nuk ka po e hedhi në votim. Konstatoj se me votat e gjithë të pranishmeve, pra me 14 vota pro miratohet kjo pike e rendit të ditës. Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje, mirupafshim në mbledhjet e radhës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 10:40 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Naim Pira
